



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 03.07.2024)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 15:38 dhe mbaroi në orën 15:52.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. Klodian Kurushi | <i>(anëtar)</i> |
| 3. Fatmira Luli | <i>(anëtare)</i> |
| 4. Irena Plaku | <i>(anëtare)</i> |
| 5. Gentiana Muçaj | <i>(anëtare)</i> |
| 6. Ridvan Hado | <i>(anëtar)</i> |
| 7. Markelian Koça | <i>(anëtar)</i> |
| 8. Yllka Rupa | <i>(anëtare)</i> |
| 9. Emona Muçi | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami si dhe nuk mori pjesë anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Alban Toro.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ilir Rusi: Përshëndetje anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Sipas njoftimit të sapo ardhur dhe për shkak të krijimit të kuorumit të nevojshëm, deklaroj të hapur mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor datë 03.07.2024, ora 15:30.

Sipas rendit të ditës, kemi shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit z. Rusi!

Atëherë, pa humbur kohë po fillojmë me dy relacionet për t’i relatuar përpara Këshillit, të cilat të dyja kanë të njëjtin objekt dhe janë dërguar nga e njëjta gjykatë që është Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në Tiranë. Kërkesat kanë objekt të përbashkët. Po lexoj kërkesën e parë.

Kjo kërkesë është paraqitur në datë 25.06.2024 dhe është regjistruar për trajtim, kërkesë për caktim gjyqtari për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë. Kërkesa është parashtruar nga zëvendëskryetari i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar sipas të dhënave të mëposhtme:

Bëhet fjalë për një çështje penale. Objekti i akuzës është nenet 317, 25, 278/1-25, 279/1, 283/2, 333/a/2, 334/1 i Kodit Penal. Numri i gjyqtarëve që kërkohet të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje është 1, numri i kërkesës është 2390 dhe numri i çështjes është 73.

Kërkoheft caktimi i një gjyqtari për plotësimin e trupit gjykues për gjykimin e çështjes penale të themelit me të pandehur shtetasin {...}. Trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët {...} dhe {...} dhe ne këtë kontekst është e nevojshme plotësimi i trupit gjykues me një gjyqtar të ri.

Kanë pengesë gjyqtarët që vijnë, pra të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, pasi një pjesë e tyre janë të konsumuar në trajtimin e çështjeve që lidheshin me kërkesat në fazën e hetimit paraprak, një pjesë e gjyqtarëve janë konsumuar për shkak të trajtimit të kërkesave në fazën e seancës paraprake, ndërkohe që një pjesë janë konsumuar për shkak të gjykimin të çështjeve që i referohen procedimeve të lidhura, të ndara nga ky procedim i fundit por që janë gjykuar paraprakisht më parë në kohë nga kolegët e tjerë të Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Ndodhur në këto kushte zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit të gjyqtarit dhe zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i pamundur për t'u aplikuar.

Zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit bëhet i pamundur për t'u aplikuar për shkak se gjyqtarët që janë përfshirë në skemën e delegimit, nuk plotësojnë kriteret ligjore për t'u përfshirë si gjyqtarë që duhet të gjykojnë çështjet penale në Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Ndërkoheft zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit bëhet i pamundur për t'u aplikuar në rastin konkret, pasi referuar nenit 46 të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", transferimi i përkohshëm me ose pa pëlqim i gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë por edhe të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar është i ndaluar.

Ndodhur në këto kushte, ne propozojmë që të vihen në zbatim mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme. Kërkesa mbështetet në paragrafin X/2 të vendimit të KLGJ-së "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, mbështetur në referencën e mësipërme si dhe në përcaktimet e shkronjës "c", pika 5 Kreu IV, i këtij vendimit të përmendur më lart, si dhe në zbatim të paragrafit VI, pika 4 të tij, ky Komisioni i propozon mbledhjes së sotme:

1. Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

2. Gjyqtarët për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë të përzgjidhen me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për gjykimin e çështjeve penale, si dhe të kenë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar.

3. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen me short për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1(një).

Në opsionin e pranimit të propozimit të mësipërm, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Për 1 (një) çështje, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, të përzgjidhen me short 1 i tillë, ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm që plotësojnë kriteret e mësipërme.

Përjashtimet nga shorti:

Referuar paragrafit VIII të Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, ...”, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e shortuar së fundmi dhe që kanë ngarkesë në Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, që është pikërisht znj. {...}. Ajo është e shortuar dy herë radhazi dhe ka në proces dy çështje gjyqësore si pjesëtare e trupit gjykues që gjykon çështje që përfshihen në kompetencën lëndore për gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Njëkohësisht kemi qëndrimin e mbajtur që të përjashtohen nga shorti ish-anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, që janë: znj. {...}, z. {...}, znj. {...}.

Lista e gjyqtarëve që i bashkëngjitet kërkesës së paraqitur nga zëvendëskryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar si dhe relacioni që është përgatitur posaçërisht për shqyrtimin e kësaj kërkesë, i bashkëngjitet këtij relacioni dhe është pjesë integrale e tij.

Nuk po i lexoj të gjithë emrat e gjyqtarëve, por ato janë të pasqyruara në këtë relacion. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime, për sa u parashtrua nga relatori z. Kurushi, nga anëtarët prezent në mbledhje.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, të vazhdohet me hedhjen e shortit nga ana e administratës.

Vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen penale nr. 73, datë 11.04.2024, gjyqtare e përzgjedhur është Eglantina Mikani.

Ilir Rusi: Falënderoj administratën për hedhjen e shortit.

I jap fjalën përsëri z. Kurushi për të relatuar relacionin tjetër për caktimin e gjyqtarëve.

Klodian Kurushi: Faleminderit z. Rusi!

Relacioni i dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar” është relacion i përgatitur ditën e sotme sepse është dërguar me urgjencë dhe për shkak të emergjencës në hartuam relacionin që ta shqyrtojmë bashkërisht në mbledhjen e sotme.

Pra sot më datë 03.07.2024, pranë KLGJ-së, është regjistruar për trajtim kërkesa për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë, kërkesë e parashtruar nga Zëvendëskryetari i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, sipas të dhënave të më poshtme:

Bëhet fjalë për një çështje penale. Objekti i akuzës nënenet 78/2, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal. Numri i gjyqtarëve që kërkohet të caktohet është një (*lapsus, pasi kërkohen dy*), numri i kërkesës është 2509 dhe numri i çështjes është 87.

Kërkohet caktimi i dy gjyqtarëve për plotësimin e trupit gjykues për gjykimin e çështjes penale të themelit me të pandehur {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, etj. Me shortin e datës 01.07.2024, gjyqtari kryesues i çështjes, është gjyqtari {...}. Sipas shkresës së paraqitur nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë rezulton se kanë pengesë gjyqtarët për shkaqet si vijon: {...}, {...} dhe {...}, që kanë pasur në gjykim dosjen penale me nr. {...} akti, datë 31.01.2024

regjistrimi, në ngarkim të të pandehurit {...}, {...} etj., në seancën gjyqësore të datës 28.06.2024, gjatë gjykimit të çështjes, kanë vendosur: veçimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurve {...} dhe {...} dhe vijim e gjykimit të tyre. Zoti {...}, më datë 13.05.2024, ka paraqitur kërkesë për dorëheqje nga gjykimi i mëtejshëm i çështjes, dorëheqje e cila i është pranuar me vendimin nr. {...}, datë 20.05.2024, të zëvendëskryetarit të gjykatës.

Me vendimin nr. {...}, datë 23.04.2024, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka vendosur: Përfundimin e gjyqtares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, {...}, nga gjykimi i çështjes penale nr. {...} regjistrimi, datë 31.01.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Gjyqtarët {...} dhe {...}, kanë kryer veprime hetimore paraprake në fazën e hetimit paraprak. Trupi gjykues i përberë nga gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} kanë dhënë vendimin e themelit me nr. {...}, datë 11.04.2023, në çështjen penale në ngarkim të të pandehurit në një procedim të lidhur, shtetasit {...}. Trupi gjykues i përberë prej gjyqtarëve: {...}, {...} dhe {...} kanë dhënë vendimin nr. {...}, datë 02.04.2024, në ngarkim të të pandehurve {...}, {...}, {...} dhe {...}, parashikuar nga nenet 79/dh, 333/a/2, 334 të Kodit Penal, (akte të dosjes së sipërcituar ndodhen të administruara në dosjen hetimore që ka ardhur për gjykim në seancën paraprake nr. {...} regjistrimi, datë 09.08.2023, në ngarkim të të {...}, {...} etj.).

Trupi gjykues i përberë prej gjyqtarëve {...}, {...} dhe {...}, kanë dhënë vendimin nr. {...}, datë 10.11.2023, në ngarkim të të pandehurve {...} dhe {...}. Gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}, kanë dhënë vendim themeli në lidhje me dosjen penale me nr. {...} akti, datë 08.03.2024 regjistrimi, në ngarkim të të pandehurit {...}, i pandehur në një procedim të lidhur me çështjen në ngarkim të të pandehurit {...}.

Ndodhur në këto kushte përmenda emrat e gjyqtarëve që kanë pengesa ligjore për t'u përfshirë në shortin e radhës për plotësimin e trupit gjykues me dy gjyqtarë të kërkuar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Edhe në këtë rast, zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit dhe zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, bëhet i pamundur për t'u aplikuar për plotësimin e trupit gjykues me dy gjyqtarë të kërkuar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Ndodhur në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon mbledhjes që të vihet në zbatim mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të

veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ai ushtron funksionin në mënyrë të përhershme. Ky rregull dhe propozim mbështetet në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”. Marrë në konsideratë kriteret e përcaktuara në paragrafin X/2 të vendimit të KLGJ-së të sipërcituar edhe më lart, duke iu referuar edhe përcaktimeve të shkronjës “c”, pika 5, Kreu IV, të këtij vendimi, në zbatim të paragrafit VI, pika 4, të tij, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, mbështetur në referencën e mësipërme si dhe në përcaktimet e shkronjës “c”, pika 5 Kreu IV, i këtij vendimi të të përmendur më lart, si dhe në zbatim të paragrafit VI, pika 4 të tij, ky Komision i Zhvillimit të Karrierës propozon:

1. Gjykata nga ku duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

2. Gjyqtarët për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë të përzgjidhen me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe të kenë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016.

3. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçanta, të jetë 2 (dy).

Në opsionin e pranimit të propozimit si më lart, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

1. Për 1 (një) çështje, për të cilën kërkohet 2 gjyqtarë, të përzgjidhen me short 2 të tillë, ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm që plotësojnë kriteret e përmendura më lart.

Përjashtimet nga shorti.

Referuar paragrafit VIII të Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e shortuar së fundmi dhe që kanë ngarkesë në Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (shkalla e parë), që siç

e përmendëm edhe më lart është gjyqtarja {...} e cila aktualisht është në proces gjykimi në dy çështje gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Njëkohësisht dhe ish-anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, që janë: znj. {...}, z. {...}, znj. {...}.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se një skemë e tillë të caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë të Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, është mundësia më e mirë për përmbushjen e nevojave të kësaj të fundit.

Bashkëlidhur relacionit janë përfshirë, të integruar edhe lista e gjyqtarëve që plotësojnë kushtet për t'u përfshirë në shortin e radhës si gjyqtarë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Në këtë listë të azhurnuar ne kemi përjashtuar ata gjyqtarët të cilët unë i përmenda më lart që kanë pengesë ligjore për të gjykuar sërish këtë çështje penale për plotësim të trupit gjykues, të kërkuar nga Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Faleminderit!

Nëse kolegët kanë ndonjë pyetje apo sqarim që unë duhet t'ia u bëj atyre, jam i gatshëm për t'iu përgjigjur pyetjeve të radhës. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime, për sa u parashtrua, nga anëtarët prezent në mbledhje.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, ftoj administratën të vazhdojë me hedhjen e shortit.

Vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen penale nr. 87, datë 28.06.2024 gjyqtarët e përzgjedhur janë Gilda Hoxha dhe Gerd Hoxha.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Me hedhjen e këtij shorti, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Pasdite të qetë.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor